



Si funksionon te ju Testi i Ovulimit Clearblue Digital

Testi funksionon duke zbuluar nivelin e rritur (shtimin) ne hormonin Luteinizng (LH) ne urinen tuaj. Rritja e nivelit te LH-se ndodh pafersisht 24-36 ore para leshimit te vezes nga vezoret tuaja, nje proces i cili njihet si ovulum. Ju keni nivelin me te larte te fertilitetit ditën kur zbulohet rritja e LH-se si dhe ditën me pas.

2 ditët me nivelin më të lartë të fertilitetit nisin që nga momenti që zbulohet rritja e LH-së. Bëni dashuri në çdo moment gjatë kësaj periudhe 48 orëshe që të maksimizoni mundësitë tuaja për të mbetur shtatzënë.

Kur duhet filluar procesi i kryerjes së testit

Për të gjetur kohëzgjatjen e ciklit tuaj menstrual, konsideroni si ditën 1 ditën e fillimit të ciklit menstrual (ditën e parë të gjakderdhjes së plotë) dhe vazhdoni duke numëruar deri në ditën përpara fillimit të periodesave tuaja të ardhshme. Numri i ditëve përbën kohëzgjatjen e ciklit tuaj.

Nëse nuk e dini kohëzgjatjen e zakonshme të ciklit tuaj ju rekomandojmë që të prisni të paktën një cikël menstrual dhe të numëroni kohëzgjatjen e këtij cikli përpara përdorimit të testit. Nëse kohëzgjatja e ciklit tuaj menstrual ndryshon me më shumë se 3 ditë, përdorni ciklin më të shkurtër që keni pasur gjatë 6 muajve të fundit për të gjetur kohën e fillimit e testit.

Nëse dëshironi të vazhdoni me testin pa patur informacion për kohëzgjatjen e ciklit tuaj menstrual, ju rekomandojmë që të filloni me kryerjen e testit ditën e 10. Gjithsesi, ju mund të mos kapni rritjen e LH-së suaj, sepse mund ta keni nisur testimin më herët ose më vonë nga sa duhet.

Përdorni tabelën e mëposhtme për të gjetur ditën e fillimit të testit. Ju mund të testoheni në çdo moment të ditës, por duhet të jetë afersisht në të njëjtën kohë çdo ditë (shumë femra e konsiderojnë si më të përshtatshëm momentin e parë herët në mëngjes). Është e rëndësishme që të mos urinoni për të paktën 4 orë para kryerjes së testit dhe njëkohësisht duhet të shmangni marrjen e tepruar të lëngjeve përpara kryerjes së testit.

Table with 21 columns (days) and 2 rows (21 ditët ose më pak, 41 ose më shumë)

Konsideroni ditën e parë të periodesave tuaja si dita 1, filloni testimin në ditën e treguar gjatë kohëzgjatjes së ciklit tuaj menstrual.

1 Në momentin që ndiheni gati për të kryer testin...

- Hiqni shkopin e testit nga mbështjellja prej letre. Përdorni atë menjëherë. Përpara aplikimit të urinës në shkopin e testit, ai duhet të futet në mbajtësen e testit. Ndiqni hapat e mëposhtëm.




2 Hiqni kapakun

- Gjeni shigjetën ngjyrë rozë mbi shkopin e testit.




3 Montoni testin

- Gjeni shigjetën ngjyrë rozë mbi mbajtësen e testit. Vendosni në vijë të drejtë dy shigjetat ngjyrë rozë. Futeni shkopin e testit në mbajtësen e testit derisa të dëgjoni një klik që tregon se është vendosur në vendin e vet dhe simboli i testit në gatishmëri të bëhet i dukshëm. Mos e përdorni deri në momentin kur shfaqet simboli i testit. Me shfaqjen e simbolit të testit në gatishmëri, vazhdoni menjëherë me kryerjen e tij. Nëse simboli i testit në gatishmëri nuk shfaqet, OSE nëse simboli zhduket, nxirreni shkopin e testit dhe vendosni atë edhe një herë me kujdes. Nëse simboli ende nuk shfaqet referojuni Q12.



4 Kryerja e testit

- Me simbolin e testit gati të shfaqur në ekran... Ose kryeni testin drejtpërdrejt në rrjedhën e urinës tuaj. Mjafton të vendosni marrësin thithës të ekzemplarit, duke e pozicionuar atë me drejtim nga poshtë në rrjedhën e urinës suaj përreth 5-7 sekonda. Kini kujdes të mos e lagni mbajtësen e testit.



5 Prisni

- Mbajeni marrësin thithës të ekzemplarit të pozicionuar me drejtim nga poshtë ose vendosni testin të pozicionuar shtirë. Gjatë kryerjes së testit, mos e mbani kurrë testin me marrësin thithës të ekzemplarit të pozicionuar me drejtim nga lart. Simboli i testit në gatishmëri do të fillojë të pulsojë pas 20-40 sekondash duke treguar testi është funksional.

- MOS E NXIRRN SHKOPIN E TESTIT. Vendosni sërish kapakun pastaj fshini urinën e tepërt. Në rastin kur simboli i testit në gatishmëri nuk pulson, referojuni Q3 në pjesën e prapme.

6 Shihni rezultatin

- Brenda 3 minutash ekrani do të shfaqë rezultatin. Nëse rezultati është ju nuk keni zbuluar rritje të LH-së suaj. Kryeni përsëri testin të nesërmen në të njëjtën kohë, duke përdorur një shkop testi të ri. Me leximin e rezultatit DUHET të shtypni butonin e nxjerrjes dhe të hiqni shkopin e testit. Rezultati i dalë nga testi mund të lexohet vetëm në ekranin e mbajtëses së testit. Ju nuk mund ta përcaktoni rezultatin nga vijat që shihni në shkopin e testit. Rezultati do të ruhet në ekran për 8 minuta.

- Nëse rezultati është ju keni zbuluar se LH-ja juaj është rritur dhe keni arritur kohën e fertilitetit tuaj maksimal. Bëni dashuri në çdo moment në harkun kohor të 48 orëve të ardhshme në mënyrë që të maksimizoni mundësinë tuaj për të mbetur shtatzënë. Nuk është e nevojshme që të kryeni testin gjatë këtij cikli. Nëse shkopin e testit është ende i pozicionuar në vend dhe ekrani tashmë është i zbrazët, nxirreni shkopin e testit dhe rezultati do të shfaqet sërish për 2 minuta. Mos e rifusni një shkop testi që është përdorur. Hidhjeni shkopin e përdorur të testit në mbetjet e zakonshme shtëpiake.

Simbolet e gabimit Në rastet kur ndodh një gabim, do të shfaqen simbole të caktuara. Shihni 'Mesazhet që tregojnë Gabimet'.

INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Hedhja e mbajtëses së testit Me përfundimin e përdorimit të mbajtëses së testit, hiqni të gjitha bateritë duke veçuar gjysmat e sipërme dhe të poshtme dhe duke filluar nga pjesa e fundit që është më afër ekranit. Hiqni të gjitha bateritë nga pjesa e poshtme e veshjes metalike qendrore. Hidhni bateritë sipas skemës së duhur të riciklimit. Kini parasysh: Mos i çmontoni, rikarikoni ose mos i hidhni bateritë në zjarr. Mos i gëlltëni ato. Mbajeni larg fëmijëve. Hidhni pjesën e mbetur të mbajtëses në përputhje me skemën e duhur të riciklimit për pajisjet elektrike. Mos i hidhni pajisjet elektrike në zjarr.

Përdorimi sërish i mbajtëses së testit Nëse mbajtësja e testit spërkatet gjatë kryerjes së testit, sigurohuni që ta fshini derisa të bëhet e pastër. Një test i mëtejshëm nuk do të ishte i mundur ndërkohë që në ekran shfaqen rezultatit apo ndonjë nga simbolet e gabimit. Ato do të qëndrojnë të shfaqura për 8 minuta (ose 2 minuta nëse ekrani juaj ishte i zbrazur dhe ju sapo hoqët shkopin e testit). Në rast se keni mbledhur urinë mund të përdorni përsëri mbajtësen e testit sapo ekrani të jetë i zbrazët. Në momentin që ndiheni gati për të përdorur përsëri mbajtësen e testit, përsëritni udhëzimet nga hapi 1 duke përdorur një shkop të ri testi.

PYETJE DHE PËRGJIGJE

- 1 Kohëzgjatja e ciklit tim menstrual është më e gjatë se 40 ditë. Kur është koha e përshtatshme për kryerjen e testit? Nëse cikli juaj është më i gjatë se 40 ditë, filloni testin 17 ditë para ardhjes së periodesave tuaja të ardhshme. 2 A është e nevojshme që të përdoren të gjitha testet? Jo, ju mund të ndaloni përdorimin e testeve, në momentin që zbuloni se LH-ja juaj është rritur dhe mund ta ruani pjesën e mbetur të shkopinjve të testit dhe mbajtëseve të testit për përdorim në ciklin e ardhshëm menstrual nëse do të lindë nevoja. 3 Unë e kam kryer një test, por simboli i testit të gatshëm nuk ka filluar të pulsojë. Çfarë do të thotë kjo? Testi nuk është kryer në mënyrën e duhur. Një simbol gabimi do të shfaqet brenda 10 minutash nga kryerja e testit. Ju duhet ta kryeni edhe një herë testin me një shkop të ri testi. Referojuni Q10 dhe pikës "Përdorimi sërish i mbajtëses së testit". 4 Unë e kam përdorur testin e ovulimit Clearblue Digital për disa muaj dhe nuk kam mbetur shtatzënë. A mund të jem e sigurt se do të mbetem shtatzënë? Mund të duhen shumë muaj për të mbetur shtatzënë. Ka shumë arsye pse nuk mund të mbeteni shtatzënë, edhe nëse keni patur mundësi

- 4 Unë e bëra testin, por ende nuk është shfaqur asnjë rezultat. Çfarë do të thotë kjo? Rezultati i testit duhet të shfaqet brenda 3 minutash pas kryerjes së testit. Nëse nuk shfaqet rezultat, do të shfaqet një simbol gabimi brenda 10 minutash. Referojuni Q10. 5 Cila është shkalla e saktësisë se testit të ovulimit ClearBlue Digital? Testet dhe ekzaminimet e shumta laboratorike kanë treguar se testi ka një saktësi që tejkalon 99% në zbulimin e nivelit të rritur të LH-së. Njoftueshmëria e testit është 40 mIU/ml. 6 Unë nuk e kam zbuluar akoma rritjen e nivelit tim të LH-së. Çfarë duhet të bëj? Nëse kohëzgjatja e ciklit tuaj menstrual ndryshon me më shumë se 3 ditë, atëherë mund të lindë nevoja për të përdorur me shumë teste në mënyrë që të zbulohet niveli i rritur i LH-së. Mund të ndodhë gjithashtu edhe për shkak se ju nuk keni ovuluar gjatë këtij cikli. Kjo nuk është e pazakontë, por ju rekomandojmë të lini një takim me mjekun tuaj nëse nuk vëreni një rritje të LH-së për 3 cikle të njëpasnjëshme. 7 A ka mundësi që ndonjë ilaç apo probleme të caktuara mjekësore të ndikojnë në rezultatit e testit? Lexoni gjithmonë udhëzimet e prodhuesit për çdo mjekim që keni marrë para kryerjes së testit. Probleme të caktuara mjekësore dhe ilaçe specifike mund të ndikojnë negativisht në ecurinë e testit: për shembull nëse jeni aktualisht shtatzënë, keni qenë kohët e fundit shtatzënë, jeni në menopauzë ose keni sindromën e vezoreve policistike, rezultatit i marrë mund të mos jetë i vërtetë. Sa më sipër mund të jetë e vërtetë edhe nëse po merrni ilaçe fertiliteti me përmbytje të hormonit Luteinizng apo Gonadotropinë Korionike njerëzore. Ju lutemi të konsultoheni me mjekun tuaj. 8 Citrat i klomifenit nuk ndikon te testet, por mund të ndikojë në kohëzgjatjen e ciklit tuaj menstrual dhe, për këtë arsye, në periudhën e kryerjes së testit. Mund të lindë nevoja që ju të nisni një paketë të re dhe të përdorni mbajtëse të reja testi dhe shkopinj testi për të vazhduar me procesin e kryerjes së testit. Nëse kohët e fundit keni ndaluar përdorimin e kontraceptivëve hormonalë, ciklet e tuaja mund të jenë të rregullta kështu që mund të ishte mirë të prisnit derisa të keni kaluar 2 cikle para kryerjes së testit. 8 Unë e kam përdorur testin e ovulimit Clearblue Digital për disa muaj dhe nuk kam mbetur shtatzënë. A mund të jem e sigurt se do të mbetem shtatzënë? Mund të duhen shumë muaj për të mbetur shtatzënë. Ka shumë arsye pse nuk mund të mbeteni shtatzënë, edhe nëse keni patur mundësi

të bëni dashuri në momentin e duhur kur niveli juaj i fertilitetit ka qenë maksimal. Ju rekomandojmë që të bëni vizitë të mjeku nëse jeni nën 35 vjeçe dhe ende nuk keni mbetur shtatzënë pasi jeni përpjekur për 12 muaj rresht. Nëse jeni mbi 35 vjeçe duhet të bëni vizitë të mjeku juaj (ose të një doktor) pasi jeni përpjekur për 6 muaj rresht dhe në rast se jeni mbi 40 vjeç vizitohuni menjëherë të mjeku juaj.

MESAZHET E GABIMIT

- 9 Në ekran është shfaqur një simbol pulsues (Gabimi A). Çfarë do të thotë kjo? Shkopi i testit është nxjerrë para kohe. Nëse nuk futet përsëri sa më shpejt të jetë e mundur, atëherë do të shfaqet një simbol tjetër gabimi. Referojuni Q10. 10 Ky simbol (Gabimi B) është shfaqur në ekran. Çfarë do të thotë kjo? Ka ndodhur një gabim gjatë kryerjes së testit. Mund të ndodhë për shkak se • Urina është aplikuar në marrësin thithës të ekzemplarit përpara se shkopi i testit të futet në mbajtësen e testit. • Marrësi thithës i ekzemplarit nuk u mbajti i pozicionuar me drejtim nga poshtë, ose testi nuk u vendos drejt, pas aplikimit të urinës në të. • Është përdorur më shumë ose më pak urinë sesa duhet. • Shkopi i testit është hequr ose shpejtë sesa duhet. Ky simbol do të shfaqet në ekran për 8 minuta. Ju duhet ta kryeni përsëri testin duke përdorur një shkop të ri testi dhe duke i kushtuar vëmendje ndjekjes së udhëzimeve. Referojuni pikës "Përdorimi sërish i mbajtëses së testit". 11 Ky simbol (Gabimi C) është shfaqur në ekran. Çfarë do të thotë kjo? Testi nuk është kryer siç duhet. Kjo mund të ndodhë për shkak se nuk janë ndjekur udhëzimet e përdorimit. Nëse keni shkopinj testi të papërdorur në paketë, mos i përdorni ata me këtë mbajtëse. Do të jetë e nevojshme të kryeni një test tjetër nga një paketë e re. Ju lutemi t'u kushtoni vëmendje udhëzimeve për përdorim. 12 Ekranin ka mbetur i zbrazët. Çfarë do të thotë kjo? Testi nuk është kryer siç duhet. Kjo mund të ndodhë për shkak se nuk janë ndjekur udhëzimet e përdorimit ose mbajtësja e testit ka marrë shumë lagështi. Nëse nuk keni aplikuar urinë në shkopin e testit nxirreni atë dhe rifilloni edhe një herë procedurën. Nëse ekrani mbetet i zbrazët ai duhet të zëvendësohet.

www.clearblue.com

Përdorni vetëm shkopinjte e testit të ovulimit Clearblue Digital me këtë mbajtëse të testit. Testi funksionon në kushtet e shtëpisë. Vetëm për përdorim diagnostikues in vitro. Ruajeni në temperaturë dhome. Mbajeni larg fëmijëve. Mos e përdorni nëse mbështjellja prej letre që ka brenda shkopin e testit është e dëmtuar. Mos e përdorni nëse shkopit të testit i ka kaluar afati i skadimit. Mos i ripërdorni shkopinjte e testit. Nuk është për përdorim kontrceptiv. Këto udhëzime jepen për modelin me numër SPD 505121 / H

SPD Swiss Precision Diagnostics GmbH (SPD), Route de St Georges 47, 1213 Petit-Lancy, Gjenevë, Zvicër. © 2015 SPD. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Clearblue është një markë tregtare e SPD. Prodhuar në Kinë.

Shpërndarë nga: OVLAŠTENI ZASTUPNIK ZA RH: Orbico d.o.o. Koturaška 69, Zagreb, Kroaci

Duke qenë se kujdesi para lindjes është shumë i rëndësishëm për shëndetin e fëmijës, ju rekomandojmë që të konsultoheni me mjekun tuaj para se të përpiqeni për të mbetur shtatzënë.

Kjo pajisje përbush kërkesat për emetime elektromagnetike të EN61326. Emetimi elektromagnetik i saj për këtë arsye është i ulët. Nuk priten ndërhyrje nga pajisje të tjera që funksionojnë me energji elektrike.

Ky test nuk duhet të përdoret në afërsi të burimeve të rrezatimit të fortë elektromagnetik, p.sh. pranë telefonave celularë, duke qenë se këta të fundit mund ta pengojnë që testi të funksionojë siç duhet.

Për të shmangur shkakimet elektrostatische, mos e përdorni testin në një mjedis shumë të thatë, veçanërisht aty ku janë të pranishme materiale me natyrë sintetike.

Table with 6 columns: IVD, Pajisje mjekësore diagnostikuese in vitro, LOT, Kodi i ngarkesës, Prodhuesi, Konsultohuni me udhëzimet e përdorimit